



Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

Albanian National Olympic Committee

Rr. "Liman Kaba", Parku Olimpik, 1001, Tiranë
Tel: +355 69 600 3707 Email: secretary.general@nocalbania.org.al <https://nocalbania.org.al>

NJOFTIM PËR POZICIONIN

“Specialist/e Eventesh”

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH) është një organizatë sportive Kombëtare e pavarur, themeluar në vitin 1958, pa qëllim fitimi, e organizuar mbi bazën e parimeve të Kartës Olimpike, dhe që funksionon sipas statutit të saj. KOKSH është organizata e vetme që përfaqëson Lëvizjen Olimpik Shqiptare, parimet e së cilës janë të detyrueshme për tu zbatuar nga të gjithë anëtarët e saj.

Në kuadër të Projektit “Ekipe Sportive 2022”, projekt i financuar nga Buxheti i Shtetit, KOKSH, fton kandidatët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e punës “Specialist/e Eventesh”.

Objektivi i përgjithshëm i Projektit është krijimi i një Programi Kombëtar që nxit 1) sportin masiv, 2) zbulimin e talenteve, 3) edukatën sportive dhe parimet olimpike. Projekti do të formojë Ekipe sportive jashtë shkollore në nivelin 9-vjecar (nga klasa e 6 – 9); në nivelin shkollë e mesme (nga klasa 10 – 12); në universitete.

Detyrat e Specialist/e Eventesh

Detyrat tuaja kryesore në këtë pozicion janë konceptimi i eventeve, ndjekja e afateve dhe organizimi në përgjithësi, komunikimi me të gjitha palët e përfshira në event si dhe përgatitja e një përshkrimi dhe raporti për secilin event. Duhet të jeni në gjendje të planifikoni një event nga konceptimi deri në zbatimin përfundimtar të tij. Për këtë arsye, duhet të jeni të organizuar dhe të keni aftësi të shkëlqyera të menaxhimi. Në këtë pozicion do të jeni përgjegjës për koordinimin e kalendarit të eventeve dhe menaxhimin e afatiteve kohore. Do të jeni përgjegjës për të mbajtur kontaktet me vendndodhjet ku do të organizohen aktivitetet, si dhe për planifikimin e aktiviteve. Kjo do të thotë që do të merreni me detaje duke filluar nga ushqimi, udhëtimi, coffee breaks, personeli ndihmës, siguria gjatë aktiviteve dhe argëtimi. Kjo punë do t'ju kërkojë të jeni krijues për të planifikuar lloje të ndryshme aktivitetesh dhe për t'i bërë sa më atraktive. Për të arritur objektivat, do të jepni dhe kontributin tuaj në zhvillimin e strategjisë së marketingut dhe komunikimit.

Kualifikimet dhe Eksperiencia:

- Arsim i lartë, minimalisht niveli bachelor;



Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

Albanian National Olympic Committee

Rr. "Liman Kaba", Parku Olimpik, 1001, Tiranë
Tel: +355 69 600 3707 Email: secretary.general@nocalbania.org.al <https://nocalbania.org.al>

- Të ketë 10+ vite eksperiencë profesionale në organizimin e eventeve në kuadër të projekteve të ndryshme; do ti jepet përparësi personave më eksperiencë në fushën e sportit.
- Njohuri shumë të mira të paketës MS Office;

Aftësi dhe kompetenca kryesore

- Të ketë aftësi shumë të mira komunikuese dhe organizative;
- I/E aftë të punojë në mënyrë të pavarur;
- Etikë pune dhe përpikmëri.

Procedura e aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentat e aplikimit si më poshtë:

- Curriculum vitae (CV) në formatin Europass;
- Letër Interesi;
- Fotokopje të diplomave universitare;
- Dokumente të tjera mbështetëse (çertifikata të fituara nga trajnime, pjesëmarrje në konferenca, botime, letra reference, etj).

Kandidatët e interesuar duhet t'i dërgojnë dokumentet e aplikimit deri më datë 16 Shtator 2022, ora 16.00, në adresën secretary.general@nocalbania.org.al, me subjekt: **Aplikim për pozicionin Specialist/e Eventesh "Ekipet Sportive 2022"**

